



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 98, datë 29.09.2022

PËR

**MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 4,289,544 LEKË, TË ALOKUARA
NGA BUXHETI I SHTETIT PËR RITJEN E PAGAVE PËR FUNKSIONIN E ARSIMIT
PARASHKOLLOR**

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.465, datë 06.07.2022 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 175, datë 8.3.2017 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar ” të ndryshuar, si dhe sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e përdorimit të fondit prej 4,289, 544 (katër milion e dyqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e dyzet e katër) lekë, të alokuara nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor, i detajuar sipas tabelës së mëposhtme:


Gr.	Kodi i instit.	Emri i institucionit	Kapitull	Programi	Projekti	Llogaria ekonomike	Fondi në lekë
00	2107008	Qendra Ekonomike e Arsimit	01	09120	90007AA	600	3,751,850
00	2107008	Qendra Ekonomike e Arsimit	01	09120	90007AA	601	537,694

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Buxhetit, Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporte dhe Komunitete Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit, Bashkia Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30.09.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 776 prot.
13

Durrës, më 07.10.2022

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.98 datë 29.09.2022 :

“Për miratimin e përdorimit të fondit prej 4.289.544 lekë, të alokuara nga buxheti i shtetit për rritjen e pagave për funksionin e arsimit parashkollor”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**PREFEKTI
EMILJAN JANI**

